



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Data: 04.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi" Korçë “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare 45214220-8

Mobilje dhe pajisje të ndryshme 39150000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

61.304.040 (gjashtëdhjetë e një milion e treqind e katër mijë e dyzet) lek, pa tvsh.

Vlera me tvsh është: 71.241.573 (shtatëdhjetë e një milion e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lek.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99 % e vlerës të përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e përllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të Ligjit nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistikte miratuar" i ndryshuar, Kreu V, nen 41, pika c.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancin/et e kërkua nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit"

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkeseve të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuveshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë përaportimin financiar standarde kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 49 %** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se 199%** i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojen e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërcohët që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të janë minimalisht në vlerat 49 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogel se 199% i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ”*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojen e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojen e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kerkuar per vertetimin e puneve te ngjashme janë kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM **Nr. 285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: ”***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për***

*përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatumore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër**, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësish i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P – 3	B	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.P – 4	A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S- 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S.- 4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
N.S - 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S – 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi”, i

ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuar janëkërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionittë fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohe në kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Mbushje ngjeshje dheu të gërmuar në kanal ,tokë e fortë	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.P – 3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Të gjitha punimet ndertimore	B, 21-50 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e madhe se 21 milion
N.P – 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri Shtrese binderi me granil gur kave,4cm,me makineri	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtresa betoni	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara

		Heqje pllaka dyshemeje Nenshtrese zhavori Shtrese betoni C 16/20 Heqje dysheme druri (binare druri + derrase + parket)		ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	15. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE Zërat që përfshihen tek "III. PUNIME HIDRO + M.K.Z."	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B Shtrese lluster cimento 1:2 t = 20 mm Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120 Zerat qe perfshihen tek 4. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI Zerat qe perfshihen tek 6. PUNIME BOJATISJE Zerat qe perfshihen tek 7. PUNIME DYER DRITARE	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	F.V Radiator për ngrohje 1200x600 copë 20 12,864.19 257.283,80 F.V Radiator 900x600 copë 7 10,740.19 75.181,33 F.V Element Radiatori 1400x600 copë 15 16,640.19 249.602,85	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Zerat që përfshihent tek II. PUNIME LEKTRIKE	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Elektrik 1(një)

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I.diploma

II- kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij nenit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**,te perfshire ne listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- a) elektricist 3 punonjës
- b) 1 (një) teknik impiante ngrohje-ftohje (per instalimin e sistemit të ngrohjes)
- c) Hidraulik 2 dy punonjës

Për stafin e sipërcituar të paraqitet

I.Kontrata e punes

II. Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vkm Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimitari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve

te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkrektisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Kerkesa per drejtuesin teknik “Inxhinier Ndertimi” Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores ”për sigurinë në kantier, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing ndertimi i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standartet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Kerkesa per **Inxhinier Hidroteknik** është vendosur për asye se ne preventiv jane parashikuar punime hidrosanitare +MKZ per kete arsyе nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing hidroteknik i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve hidrosanitare +MKZ, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standartet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Kerkesa per **Inxhinier Elektrik** është vendosur për asye se ne preventiv jane parashikuar punime elekrike per kete arsyе nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing elektrik i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve elekrike, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standartet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Kerkesa per 3 punonjes te specializuar “Elektricist” eshte vendosur per arsyе se ne preventiv jane parashikuar punime elekrike për të cilat nga zbërthimi i orëve të punës nevojiten te paktën 3 punonjes elektristë të cilët do të zbatojnë punimet.

Kerkesa per 1 (një) teknik impiante ngrohje-ftohje (per instalimin e sistemit të ngrohjes) eshte vendosur per arsyе se ne preventiv jane parashikuar janë parashikuar heqje vendosje radiatorësh për të cilat nga zbërthimi i orëve të punës nevojitet të paktën 1 teknik impjante ngrhoje-ftohje i cili do të zbatojë punimet

Kerkesa per 2 punonjes te specializuar “hidraulik” eshte vendosur per arsyе se ne preventiv jane parashikuar punime hidraulike për të cilat nga zbërthimi i orëve të punës nevojiten te paktën 2 hidraulikë të cilët do të zbatojnë punimet.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **50 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontribuiteve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtes deri 5 ton	Cope 3	ne pronesi ose me qira
Betoniere	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Rul	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Asfaltosħruess	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Fabrikë asfaltobetoni	Cope 1	ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

-Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë pér transport mallrash brenda vendit.

Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qeraxe vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë pér transport mallrash brenda vendit.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 , referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,çertifikate e transportit te mallrave) , mjetet nuk duhet te rezultojne per perdonim vetjak por per perdonim nga te tretet)

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publike ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet te kontrata e qeraxe vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

➤ Për Fabrikën e asfaltobetonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, planvendosjen e saj dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

-Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata e qeraxe, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, shoqeruar me dokumente qe vertetojne

pronesine e saj planvendosjen e saj dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

- Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj. Gjithashtu ofertuesi duhet te paraqesë një deklaratë ku te deklarojë që prodhuesi është i pajisur me leje mjedisore për fabrikën e asfaltobetonit .

Shenim: Lidhur me fabriken e asfaltobetonit ofertuesit duhet te kene ne pronesi,me qera apo te lidhin kontrate furnizimi me një fabrike vendndodhja e se ciles cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike te percaktuara ne VKM Nr.628 date 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve”

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njofshit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij nenit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinave të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinave të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Numri i fuqisë punëtore eshte llogaritur ne baze te zberthimit te grafikut te punimeve, zberthimit te preventivit dhe natyres se objektit, numri **prej 50 personash** përfshin personelin kryesor drejtues teknik, specialiste dhe punëtorë të përllogaritur nga zbërvihimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushes rezulton se :

Sasia e oreve te punes sipas manualit dhe analizave teknike eshte 32095 ore. Llogaritja e numrit te punonjësve ne varesi te oreve te punes dhe afatit te kontrates eshte si me poshtë:

<i>Totali orë pune + orë makineri</i>	<i>32095</i>
<i>Ditë pune (orë pune/8)</i>	<i>4012</i>
<i>Specialiste,punetore per 4 muaj</i>	<i>46</i>
<i>Ing. ndërtimi</i>	<i>1</i>
<i>Ing. hidroteknik</i>	<i>1</i>
<i>Ing. elektrik</i>	<i>1</i>
<i>teknik impiante ngrohje-ftohje</i>	<i>1</i>
<i>Numri i punëtorëve gjithsej</i>	<i>50</i>

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyren dhe volumin e punimeve te parashikuara ne preventiv .

Lloji i Makinerive	Sasia	Argumentimi
Kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	Cope 1	Nevojitet per transportin e binderit dhe asfaltit
Kamion me kapacitet mbajtes deri 5 ton	Cope 3	Nevojiten per transportin e materialeve ndertimore dhe pajisjeve . Nevojiten 3 cope per shkak të sasive të materialeve dhe pajisjeve te parashikuara
Betoniere	Cope 1	Nevojitet per berjen e betonit te pusetave te shkarkimit te ujrale
Rul	Cope 1	Nevojitet per ngjeshjen e binderit dhe asfaltit
Asfaltoshtruese	Cope 1	Nevojitet per shtrimin e binderit dhe asfaltit
Fabrikë asfaltobetoni	Cope 1	Kerkohet per shkak se në preventiv janë parashikuar punime per shtrimin me binder dhe asfalt
Tokmak elektrik	Cope 1	Nevojitet per ngjeshjen e shtresave te kanalit te shkarkimit te ujrale te bardha

2.2.7 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte :

- Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise”
- Çertifikaten ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërise.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standarde menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standarde e kërkua të cilësisë. Sistemi i menaxhimit shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbijnë autoritetit kontraktor për njojen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përmbrashjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standarde kërkua të cilësisë, përfshirë edhe standarde për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku perfshihen Specifikimet Teknike, Projekti, Preventivi dhe Grafiku i Punimeve per këtë objekt janë dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, pjese perberese e struktura se Bashkise Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar).

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike janë marre ne konsiderate kërkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili eshte publikuar se bashku me dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT